



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA PËR NDIHMËN EKONOMIKE DHE PERSONAT ME AFTËSI**  
**NDRYSHË**

Nr. 1613 Prot

Shkodër, më 25.01.2024

**Lënda:** Dërgim Projekt-Vendimi

**KËSHILLIT BASHKIAK**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për miratim Projekt - Vendimin dhe Relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Personat me Aftësi ndryshe:

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET APLIKUESE, TË CILAT NUK JANË SHPALLUR PËRFITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT DHE QË DO TË TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%) PËR NDIHMËN EKONOMIKE.**

**KRYETAR**

**BENET BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**  
**ZV/ KRYETAR**

**Onid Bejleri**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA PËR NDIHMËN EKONOMIKE DHE PERSONAT ME AFTËSI  
NDRYSHE

Nr. \_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**PROJEKT VENDIM**

Nr \_\_\_\_ datë \_\_\_\_

Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike.

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 21 të Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 597 datë 04.09.2019 " Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", kreu IV, pika 1, si dhe bazuar në relacionin e administratës:

**VENDOSI:**

- 1.Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar ( 6% ) për ndihmën ekonomike, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**BENET BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**

**ZV/KRYETAR**

**Onid Bejleri**

Adresa: Rr. 16 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, tëb: [eëë.bashkiashkoder.gov.al](http://eëë.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)



**KRITERET PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%).**

Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT (Total 100)	DOKUMENT KONFIRMUES
1	Familje njëprindërore me një ose më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç.	19	Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle
2	Familje me 1-2 anëtarë me moshë mbi 50 vjeç secili (pa të ardhura).	17	Çertifikatë familjare
3	Familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara apo invalid pune.	15	Çertifikatë familjare, kopje vendimi nga Kom.mjeko- ligjor
4	Familje të ngujuara për gjakmarrje.	13	Çertifikatë familjare, vërtetim nga Dr. Raj. e Policisë së Shtetit
5	Familje që kanë k/familjarin në burg apo për kurim brenda vendit.	11	Çertifikatë familjare, vërtetim nga institucioni vuajtjes së denimit/ose kom. mjeko-ligjor
6	Familje me 3 apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç.	9	Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle
7	Familje në proces divorci.	7	Çertifikatë familjare, vërtetim nga Gjykata
8	Familje që kanë anëtarë madhor të humbur apo zhdukur dhe si të tillë nuk mund të paraqiten tek administratori çdo tre muaj për deklaram.	5	Çertifikatë familjare, vendim/vërtetim nga Gjykata
9	Familje të prekura nga fatkeqësitë natyrore.	3	Çertifikatë familjare, konfirmim nga sektori i emergjencave civile pranë bashkisë
10	Çdo kategori tjetër familje në nevojë e cila nuk mund të plotësojë nevojat bazë jetike.	1	Çertifikatë familjare

Drejtorja e Ndihmës ekonomike

*Flavio Malocaj*

Drejtorja Juridike

*B. Xhepa*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA PËR NDIHMËN EKONOMIKE DHE PERSONAT ME AFTËSI  
NDRYSHE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_ .2024

## RELACION

**Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike.**

**Të nderuar anëtarë të këshillit bashkiak,**

Referuar dispozitave të ligjit Nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 21 të Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar, VKM nr. 597 datë 04.09.2019 " Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", i ndryshuar,

Këshilli Bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar deri në 6%, përzgjidhen nga lista familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike brenda tre muajve të fundit, nëpërmjet regjistrit elektronik kombëtar dhe nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit me arsyen "nuk ka marrë pikët e mjaftueshme".

Për familjet të cilat do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) duhet të kryhet paraprakisht vlerësimi social-ekonomik në familje nga administratori shoqëror.

Që nga filli i implementimit të skemës së re të Ndhmës Ekonomike, vihet re një përqindje e lartë e familjeve aplikuese për ndihmë Ekonomike, të cilat janë të përjashtuara nga sistemi elektronik kombëtar për mos plotësim pikësh.

Gjithashtu mbetet akoma i pakuptueshëm kufiri i varfërisë, pasi familjet përfituese shpesh herë janë familje që kanë deklaruar të ardhura dhe ato jopërfituese janë familje pa asnjë të ardhur.

Nuk ka një tavan minimal apo maksimal pikësh për familjet përfituese dhe jo përfituese.

Referuar dokumentacionit që disponojmë, rezulton një numër i madh familjesh të një shkalle të lartë varfërie të refuzuara nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh, si :

- Familje me 1 ose 2 anëtarë të moshës mbi 50 vjeç, të cilët janë në pamundësi punësimi nga strukturat shtetërore mbështetëse, të pamundur për punë për arsye shëndetsore apo moshe.
- Familje njëprindërore me një ose më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç.
- Familje në proces divorci.
- Familje me pjestarë invalid punë apo persona me aftësi të kufizuar.
- Familje me probleme gjakmarrje.
- Familje që kanë k/familjarin në burg.
- Familje me anëtarë mbi moshë pune që nuk perfitojnë pension.

Më poshtë kemi dhënë të detajuar, tabelen e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%), të hartuar nga specialistët tanë.

Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT (Total 100)	DOKUMENT KONFIRMUES
1	Familje njëprindërore me një ose më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç.	19	Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle
2	Familje me 1-2 anëtarë me moshë mbi 50 vjeç secili (pa të ardhura).	17	Çertifikatë familjare
3	Familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara apo invalid pune.	15	Çertifikatë familjare, kopje vendimi nga Kom.mjeko- ligjor
4	Familje të ngujuara për gjakmarrje.	13	Çertifikatë familjare, vërtetim nga Dr. Raj. e Policisë së Shtetit
5	Familje që kanë k/familjarin në burg apo për kurim brenda vendit.	11	Çertifikatë familjare, vërtetim nga institucioni vuajtjes së denimit/ose kom. mjeko-ligjor

6	Familje me 3 apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç.	9	Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle
7	Familje në proces divorci.	7	Çertifikatë familjare, vërtetim nga Gjykata
8	Familje që kanë anëtarë madhor të humbur apo zhdukur dhe si të tillë nuk mund të paraqiten tek administratori çdo tre muaj për deklaram.	5	Çertifikatë familjare, vendim/vërtetim nga Gjykata
9	Familje të prekura nga fatkeqësitë natyrore.	3	Çertifikatë familjare, konfirmim nga sektori i emergjencave civile pranë bashkisë
10	Çdo kategori tjetër familje në nevojë e cila nuk mund të plotësojë nevojat bazë jetike.	1	Çertifikatë familjare

Ju ftojme që t'i merrni në konsideratë kriteret e hartuara nga administrata, në menyrë që nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike, të përfitojnë familjet më vulnerabël, të cilat rezultojnë të refuzuara nga sistemi i pikëzimit (për mungesë pikësh).

*Duke ju falenderuar,*

**KRYETAR**

**BENET BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**

**ZV. KRYETAR**

**Onid Bejleri**

